



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 17 21

Më: 24.02.2021

Mamushë

Në bazë të nenit 58 pika të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit të Prokurimit Publik Nr.04/L-042, Rregulloreve të Prokurimit Publik si dhe nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 dhe Rregulloreve të Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Mbikqyrësit të drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës

I

Emërohet **z. Şakir Mazrek** Mbikqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës për “Ndërtimi e objektit të Qendrës Kryesore të Mjeksisë Familjare” në Mamushë.

II

Përgjegjësitë e Mbikqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:

1. Mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të implementimit të kontratës;
2. Administrimin e plotë të kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual në kontratë;
3. Rishikimi, aprovimi dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij.

III

Mbikqyrësi i Drejtpërdrejtë Menaxheri i Kontratës duhet t'i përmbahet me përpikëri Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhmin e kontratës.

IV

Ky vendim fillon se zbatuari prej datës 1 mars 2021.



V

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.

Me këtë vendim të njoftohet:

- Z. Šakir Mazrek;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale dhe
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës
Abdullahi Krasniç





REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS

OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosovo-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 16-21
Tarih/Dt.	28.02.2021

02 Nr. 21

Më: 22.02.2021

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik A01 neni 61.15, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.

I

Menaxher i kontratës për projektin me titull: **“Furnizimi me barëra për Qendrën e Mjekësisë Familjare në Mamushë”** me nr. të kontratës: 626-21-61-121/C86 emërohet z. Mirat Morina. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet z. Rëjdi Mazrek.

II

Pas pranimit të kontratës, menaxheri i kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin “Fillimi/mobilizimi i kontratës”. Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlerë të madhe, të mesme dhe të vogël. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të menaxherit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik, menaxheri i kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.

III

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës:

Menaxheri i Projektit do të:

- Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
- sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë dhe
- Bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.